



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 30

Tiranë – E hënë, 4 nëntor 2024

PËRMBAJTJA

Njoftim i Kryeministrit
nr. 5984, datë 1.11.2024

Për kandidim për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të
Këshillit të Statistikave, përfaqësues të botës akademike.....

Faqe

3



NJOFTIM

Nr. 5984, datë 1.11.2024

**PËR KANDIDIM PËR PËRZGJEDHJEN
E KANDIDATËVE PËR ANËTAR TË
KËSHILLIT TË STATISTIKAVE,
PËRFAQËSUES TË BOTËS AKADEMIKE**

Në mbështetje të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikat zyrtare”, dhe të pikës 2, të vendimit nr. 670, datë 7.11.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”, shpallim njoftimin për kandidim për anëtar të Këshillit të Statistikave.

Konkurrimi është i hapur për përfaqësuesin që i përket **botës akademike**.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për anëtar të Këshillit të Statistikave, përfaqësues të botës akademike, janë, si më poshtë vijon:

Kandidati për anëtar, përfaqësues i botës akademike, duhet që:

i. të jetë nga radhët e personelit akademik, i punësuar me kohë të plotë, në institucione të arsimit të lartë, publik ose privat, të licencuar e të akredituar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;

ii. të ketë përvojë në punë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në fushën e statistikave ose të ekonomisë apo shkencave të natyrës;

iii. të zotërojnë tituj akademikë.

Kritere të përgjithshme:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të jetë person i padënuar apo ndaj të cilit nuk janë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar.

Shënim. Kandidatët për anëtar në Këshillin e Statistikave duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë dokumentacionin që provon plotësimin e kriterëve, sipas këtij njoftimi.

Afati i dorëzimit të aplikimit është deri më 29.11.2024, dhe të dorëzohet në adresën e Kryeministrit. Kandidatët e kualifikuar do të njoftohen nëpërmjet *e-mail*-it.

Adresa: Kryeministria

**Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 1,
1000**

Tiranë, Shqipëri

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm

Tel.: 04 22 77 401

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2024

